



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Shpallen fituesit e Fondit të Përkthimit Letrar për vitin 2018

2018-03-31 14:43:00

Fondi
Përkthimit
Letrar
Botues

Ministria e Kulturës, në vijueshmëri të politikave mbështetëse në fushën e letrave, shpall sot listën e fituesve të Fondit të Përkthimit Letrar për vitin 2018. Fondi për Përkthimin Letrar (FPL), i themeluar në vitin 2014, dëshmon në të pestin vit për vëmendjen e Ministrisë së Kulturës në nxitjen dhe mbështjen financiare të përkthime të arrira të veprave të rëndësishme artistike të letërsisë europiane dhe asaj botërore në gjuhën shqipe, në nxitjen e përkthimit cilësor dhe promovimin e tij si një nga format më të rëndësishme artistike të shprehjes letrare.

Ministria e Kulturës, në vijueshmëri të politikave mbështetëse në fushën e letrave, shpall sot listën e fituesve të Fondit të Përkthimit Letrar për vitin 2018.

Fondi për Përkthimin Letrar (FPL), i themeluar në vitin 2014, dëshmon në të pestin vit për vëmendjen e Ministrisë së Kulturës në nxitjen dhe mbështjen financiare të përkthime të arrira të veprave të rëndësishme artistike të letërsisë europiane dhe asaj botërore në gjuhën shqipe, në nxitjen e përkthimit cilësor dhe promovimin e tij si një nga format më të rëndësishme artistike të shprehjes letrare. Gjatë këtyre viteve janë mbështetur 55 përkthime cilësore të sjellë në shqip nga përkthyes si : Zef Simoni, Edmond Tupja, Afrim Koçi, Piro Misha, Klio Evangjeli, Adrian Beshaj, Diana Kastrati, Ildir Azizaj, Rudi Erebara, Edit Dibra, Bajram Karabolli, Ledia Dushi, Agron Tufa, Parid Teferiçi, Ben Andoni, Romeo Çollaku, Virgjil Muçi, Klara Kodra e shumë të tjerë.

Fondi për Përkthimin Letrar u vjen gjithashtu në ndihmë botuesve për të ulur kostot e librit duke ndikuar në rritjen e cilësinë së katalogut të tyre.

Përmes FPL-s Ministria e Kulturës kujdeset që të vendoset standardi i respektimit të së drejtës së autorit si një nga kushtet e domosdoshme për t'u përzgjedhur.

Nga 20 aplikime të shtëpive botuese e përkthyesve, u përzgjedhën 14 prej tyre të cilët kaluan me sukses fazën e seleksionimit nga kolegji dhe më pas nga ekspertët e fushës së përkthimit.

Brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së fituesve, do të kontaktohen përkthyesit dhe shtëpitë botuese të përzgjedhura për të caktuar afatin e nënshkrimit të kontratës.

<u>Shtëpia botuese</u>	<u>Titulli i librit</u>	<u>Autori</u>	<u>Përkthyesi</u>
<u>Aleph Klub</u>	<u>Poezi</u>	<u>Ted Hughes</u>	<u>Viola Adhami</u>
<u>Botime IDK</u>	<u>Bilanc Gjuetie</u>	<u>Olga Tokarczuk</u>	<u>Astrit Beqiraj</u>
<u>Pika pa Sipërfaqe</u>	<u>Remains et contes</u>	<u>Voltaire</u>	<u>Redi Sheqeri</u>
<u>Toena</u>	<u>Missing you</u>	<u>Harlan Coben</u>	<u>Maniela Sota</u>
<u>Albas</u>	<u>White Noise</u>	<u>Don DeLillo</u>	<u>Luljeta Lleshanaku</u>
<u>Media Print</u>	<u>Les vacances du Petit Nicolas</u>	<u>Rene Goscinny & Jean-Jacques Sempe</u>	<u>Adriana Koxha</u>
<u>Ombra GVG</u>	<u>L'isola di Arturo</u>	<u>Elsa Morante</u>	<u>Edmond Çali</u>
<u>SHB Onufri</u>	<u>As I Lay Dying</u>	<u>William Faulkner</u>	<u>Granit Zela</u>
<u>Fan Noli</u>	<u>Baudelaire</u>	<u>Jean Paul Sartre</u>	<u>Primo Lec Shllaku</u>
<u>Ditura</u>	<u>El Laberinto de los Espiritus</u>	<u>Carlos Ruiz Zafon</u>	<u>Flavia Kaba</u>
<u>Skanderbeg Books</u>	<u>Pranverë në Fialtë</u>	<u>Vladimir Nabokov</u>	<u>Korab Hoxha</u>
<u>Dudaj group</u>	<u>Two Years Eight Months and Twenty –Eight Nights</u>	<u>Salman Ruzhdie</u>	<u>Ilir Baci</u>
<u>Fjala</u>	<u>Patria</u>	<u>Fernando Aramburu</u>	<u>Bashkim Shehu</u>
<u>Pegi</u>	<u>The beautiful and damned</u>	<u>F. Scott Fitzgerald</u>	<u>Alina Karaulli</u>